



A.nr.742/2026

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës–Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Ardita Haxhnikaj Demi, kryetare, Malsore Gashi Bajraktari dhe Eshref Shabani, anëtarë, më Argjenda Sherifi, në cilësinë e procesmbajtëses, në procedurë sipas ankesës me numër A.nr.742/2026, të datës 06.07.2026, të parashtruar nga ankuesi A.H, nga Prishtina, të cilin me autorizim e përfaqëson avokat Alban Krasniqi, në çështjen juridike “*kërkesë nga marrëdhënia e punës*”, duke vepruar në pajtim me nenin 6, paragrafin 1, nën paragrafin 1.1, nenin 16, paragrafin 3 dhe nenin 18, paragrafin 1, nën paragrafin 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim të datës 20.07.2026, mori këtë:

V E N D I M

- I. Refuzohet si e pabazuar** ankesa me numër A.nr.742/2026, e datës 06.07.2026, e parashtruar nga ankuesi A.H.
- II. Mbetet në fuqi** Vendimi Nr. 01-120/01-27698, i datës 12.06.2026, i Udhëheqësit të Njesisë së Burimeve Njerëzore të Komunës së Gjakovës.

A r s y e t i m

Ankuesi A.H (*tutje referuar vetëm ankuesi*), më datë 06.07.2026, ka parashtruar ankesë kundër Vendimit Nr. 01-120/01-27698, të datës 12.06.2026, të Udhëheqësit të Njesisë së Burimeve Njerëzore të Komunës së Gjakovës.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës (*tutje Këshilli*) bazuar në dispozitat e Rregullores Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, më datë 09.07.2026, ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankesë tek Komuna e Gjakovës, ndërsa, kjo e fundit më datë 10.07.2026, ka dërguar përgjigjen në ankesë.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, për shqyrtimin e kësaj lënde ka administruar këto prova: Ankesën me numër protokolli 2955/2026 të datës 06.07.2026, e parashtruar nga ankuesi në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës të Shërbimit Civil të Kosovës; Vendimin me numër 01-120/01-27698 e datës 12.06.2026, Kërkesën për kompozim e datës 29.05.2026; Autorizimin e datës 02.04.2026; Kërkesën për përgjigje në ankesë e datës 09.06.2026; Përgjigje në anekse e datës 10.07.2026; Akt Emërimit e ankuesit me numër 01-112/01-41885 e datës 11.08.2025; Kartelën financiare të datës 10.06.2026.

Kolegji i Këshillit pas shqyrtimit dhe analizimit të shkresave të lëndës të parashtruara nga palët në procedurë, ka gjetur se ankesa e ankuesit është e pabazuar, *sepse*:

I. Gjendja e çështjes

Nga shqyrtimi i provave të administruara rezulton se:

- Ankuesi sipas Aktit të Emërimit nën shenjen 01-112/01-41885, të datës 11.08.2025, mbanë pozitën Udhëheqës i Sektorit të Inspektoratit të Tregut në kuadër të Drejtorisë për Inspektime në Komunën e Gjakovës.
- Ankuesi përmes përfaqësuesit të tij më autorizim, më datë 29.05.2026, i është drejtuar më kërkesë Komunës së Gjakovës, për kompensimi në diferencës së paguar të përvojës së punës për periudhën 05.02.2023 deri 31.12.2025.
- Udhëheqësi i Njesisë për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore në Komunën e Gjakovës më Vendimin Nr. 01-120/01-27698 të datës 12.06.2026, ka refuzuar kërkesën e ankuesit të datës 29.05.2026.

II. Pretendimet ankimore

Ankuesi në ankesën e parashtruar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, kundërshton Vendimin Nr. 01-120/01-27698, të datës 12.06.2026, Udhëheqësit të Njesisë së Burimeve Njerëzore të Komunës së Gjakovës, më pretendimin që Komuna e Gjakovës më vendimin e atakuar ka cenuar të drejtën e kompensimit të përvojës së punës, si e drejtë nga marrëdhënia e punës. Kërkon që të aprovohet si e bazuar ankesa, të anulohet akti i kundërshtuar dhe të detyrohet Komuna e Gjakovës, që brenda afatit të përcaktuar nga Këshilla të ndërmor të gjitha veprimet e nevojshme për kompensim e diferencës së papaguar të shtesës së përvojës së punës nga 0.25% në 0.5% (për çdo vit përvojë pune) për periudhën nga data 05.02.2023 deri 31.12.2025, përfshirë kamatëvonesën prej 8% dhe shpenzimet tarifës së avokatit.

III. Vlerësimi i Kolegjit

Lidhur me pretendimin e ankuesit referuar kompensimit lidhur më përvojën e punës, Kolegji i Këshillit iu referua nenit 6, paragrafi 6 të Ligjit Nr. 08/L-196 për Pagat në Sektorin Publikë, me të cilin është përcaktuar se: “6. Paga bazë rritet në bazë të përvojës së punës, në masën: 6.1. zero pikë njëzetë e pesë për qind (0.25%) për çdo vit të plotë pune, deri në pesëmbëdhjetë vite (15) punë; dhe 6.2. zero pikë pesë për qind (0.5%) për çdo vit të plotë pune, mbi pesëmbëdhjetë vite (15) punë”, dispozita këto të cilat i janë nënshtruar vlerësimit të kushtetutshmërisë nga ana e Gjykatës Kushtetuese, më ç’rast, kjo e fundit, me Aktgjykimin për rastin nr. KO79/23, në pikën II të dispozitivit ka konstatuar se paragrafi 6 i nenit 6 (Paga bazë) të Ligjit Nr.08/L-196 për Pagat në Sektorin Publik, nuk është në përputhshmëri me paragrafët 1 dhe 2 të nenit 46 [Mbrojtja e Pronës] të Kushtetutës në ndërlidhje me nenin 1 (Mbrojtja e pronës) të Protokollit nr.1 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut; ndërsa, në pjesën arsyetues gjegjësisht në pikët 380 dhe 381 ka sqaruar: 380. Gjykata ka konstatuar se paragrafi 6 i nenit 6 (Paga bazë) dhe paragrafët 2, 3 dhe 4 të nenit 41 (Shtesa tranzitore) të Ligjit të kontestuar janë në kundërshtim me Kushtetutën, përkatësisht me të drejtën në gëzimin paqësor të pronës dhe barazinë para ligjit. Kjo, sipas sqarimeve të dhëna në Aktgjykim, ndër të tjera, sepse (i) zbritja joproporcionale e nivelit të pagave të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Kosovës është në kundërshtim të plotë me

parimet kushtetuese, ligjore, parimet relevante ndërkombëtare dhe praktikën gjyqësore të Gjykatës Kushtetuese dhe përtej cenimit të të drejtave respektive individuale, rezulton edhe në cenim të ndarjes dhe balancimit të pushteteve dhe vlerave të Republikës së Kosovës;....ndërsa (v) përgjysmimi i shtesës për përvojën e punës për të gjithë kategorinë e funksionarëve/zyrtarëve/nëpunësve për pesëmbëdhjetë (15) vitet e para të përvojës së punës, kufizon të drejtat dhe liritë themelore të tyre, pa asnjë qëllim legjitim në kundërshtim me përcaktimet e nenit 55 të Kushtetutës. 381. Thënë këtë, sipas sqarimeve të dhëna më sipër ndërlidhur dhe me efektin e Aktgjykimeve të Gjykatës, kjo e fundit (i) nuk do të shfuqizojë paragrafin 6 të nenit 6 (Paga bazë) të Ligjit të kontestuar, ndërsa (ii) do të shfuqizojë paragrafët 2, 3 dhe 4 të nenit 41 të Ligjit të kontestuar. 382 Kjo sepse, lidhur me paragrafin 6 të nenit 6 të Ligjit të kontestuar që ndërlidhet me shtesën mbi pagën për përvojën e punës, Ligji i kontestuar në paragrafin 1 të nenit 45 të tij, ka shfuqizuar edhe Ligjin nr.03/L-147 për Pagat e Nëpunësve Civilë, i cili përfshin nenin 18 (Shtesa mbi pagën për përvojën e punës) sipas të cilit, për çdo vit të përvojës së punës të kaluar në shërbimin civil dhe jashtë tij, përveç përvojës së kaluar në punë praktike, nëpunësit civil sipas këtij ligji i takon e drejta shtesë në pagën bazë prej zero pikë pesë përqind (0,5%). Shpallja e pavlefshme e paragrafit 6 të nenit 6 të Ligjit të kontestuar i kombinuar me faktin që Ligji nr.03/L-147 për Pagat e Nëpunësve Civilë shfuqizohet gjithashtu përmes paragrafit 1 të nenit 45 të Ligjit të kontestuar, do të rezultonte në zbrazëti ligjore, përkritazi më të drejtën për shtesa mbi pagën për përvojën e punës. Për pasojë, duke balancuar parimin e sigurisë juridike dhe të drejtat dhe liritë themelore, Gjykata do të lë **në fuqi paragrafin 6 të nenit 6 të Ligjit të kontestuar në periudhën prej gjashtë (6) muajve pas hyrjes në fuqi të këtij Aktgjykimi, duke i përcaktuar detyrimin Kuvendit, që brenda kësaj periudhe të ndryshojë dhe/ose plotësojë paragrafin 6 të nenit 6 të Ligjit të kontestuar në pajtim me konstatimet e këtij Aktgjykimi. Në ndryshimin dhe/ose plotësimin e paragrafit 6 të nenit 6 të Ligjit të kontestuar, Kuvendi duhet të ketë parasysh që efektet e ndryshimit/plotësimit të tij në kontekst të lartësisë së shtesës për përvojën e punës burojnë që nga hyrja në fuqi e këtij Aktgjykimi”**.

Andaj, duke qenë se Kuvendi i Kosovës brenda afatit të përcaktuar nga Gjykata Kushtetuese nuk ka bërë plotësim/ndryshimin e paragrafit 6 të nenit 6 të Ligjit Nr.08/L-196 për Pagat në Sektorin Publik, Këshilli në mungesë të këtij rregullimi ligjor, nuk ka juridiksion që të detyroj institucionet publike të bëjnë kompensimin e përvojës së punës për zyrtarët publikë sipas interpretimit kushtetues dhe rrjedhimisht pretendimi ankimor lidhur me kompensimin për përvojën e punës sikurse pretendohet në ankesë është i pabazuar.

Thënë më tepër, e bazuar në përcaktimet kushtetuese sipas Aktgjykimit në rastin nr. KO79/23, Këshilli tashme ka qëndrim të konsoliduar që rregullat dhe kushtet lidhur më pagat dhe kompensimet tjera të të punësuarve në sektorin publik janë ekskluzivisht rregullim i ligjit për pagat në sektorin publik dhe se efektet e Aktgjykimit në rastin nr. KO79/23, referuar paragrafit 6 të nenit 6 të Ligjit Nr.08/L-196 për Pagat në Sektorin Publik do të rrjedhin nga data e publikim të këtij aktgjykimin (pra nga data 28.04.2024).

Kolegji bazuar në nenin 18, paragrafi 1, nën paragrafi 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës si dhe nenin 132 paragrafi 2 i Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshëm Administrative, vendosi si në dispozitivit të këtij vendimi.

Këshillë juridike: Ky vendim hynë në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetarja e Kolegjit. Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Administrative në Prishtinë-Departamenti për Konteste të Punës, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS

A.nr.742/2026

Argjenda SHERIFI

Procesmbajtëse

Ardita Haxhnikaj-DEMI

Kryetare e Kolegjit

Vendimi i dërgohet:

- Përfaqësueses së ankuesit Avokat Alban Krasniqi;
- Njesisë së Burimeve Njerëzore në Komunën e Gjakovës dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së.